



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 98, datë 07/06/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 11, datë 15.02.2021, e z. A.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” nga ana e Bashkisë Shkodër dhe OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Shkodër,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Z. A.K. është individ me aftësi të kufizuara dhe prej disa vitesh është shitës ambulant në qytetin e Shkodrës. Në këtë mënyrë, Z. A.K. me bashkëshorten e tij, znj. Shpresa A.K., e cila është gjithashtu me aftësi të kufizuara, sigurojnë jetesën për familjen e tyre. Për të ushtruar aktivitetin si shitës ambulant, ankuesi duhet të pajiset me lejen përkatëse nga ana e Bashkisë Shkodër, të cilën e ka marrë për disa vite me rradhë nga ky institucion. Në datën 26.12.2020, ankuesi pretendon se i është drejtuar Bashkisë Shkodër me shkresë zyrtare për t’u pajisur me lejen e ushtrimit të aktivitetit, por ai pretendon se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ky institucion. Një gjë e tillë ka sjellë probleme për ankuesin, pasi ndaj tij janë vënë gjoba si pasojë e kontrolleve të shpeshta të kryera nga Policia Bashkiake ndaj shitësve ambulantë.

Një problem tjetër i hasur nga z. A.K. është edhe fakti se OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Shkodër, në mungesë të lejes së ushtrimit të aktivitetit, nuk lidh kontratë të furnizimit me

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

energji elektrike me më, për matësin e vendosur në rulotë, pasi kontrata e paraardhëse ka qenë në emër të personit që ka shfrytëzuar me parë rulotën.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se po diskriminohet nga dy institucionet e sipërcituara për shkak të aftësisë së tij të kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 11, datë 15.02.2021, së z. A.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Shkodër dhe OSHEE sh.a., Drejtorisë Rajonale Shkodër, me shkresën nr. 307/1, datë 19.02.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

➤ **Për Bashkinë Shkodër:**

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
- Informacion lidhur me periudhën kohore, që ankuesi ushtron aktivitetin e shitësit ambulant në qytetin e Shkodrës, si dhe të dërgohen kopje të lejeve respektive për çdo vit;
- Informacion nëse ankuesi ka depozituar kërkesë në datën 26.12.2020, pranë Bashkisë Shkodër, për rinovim të lejes për ushtrim aktiviteti;
- Nëse po, të depozitohet kopje e kërkesës së ankuesit dhe kopje e shkresës kthim përgjigje të Bashkisë Shkodër;
- Informacion mbi arsyet e mos rinovimit të lejes së ushtrimit të aktivitetit për z. A.K.;
- Çdo informacion tjetër, që ka lidhje me çështjen objekt ankese.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

➤ **Për OSHEE sh.a., Dega Rajonale Shkodër:**

1. Informacion, nëse z. A.K. ka depozituar pranë OSHEE sh.a. Dega Rajonale Shkodër, kërkesë për të lidhur kontratë të re shërbimi për furnizim me energji elektrike për rulotën që ai ka në shfrytëzim;
 2. Nëse po, të dërgohet një kopje e kërkesës së tij, si dhe të dërgohet informacion nëse kërkesa e tij është refuzuar nga shoqëria, si pasojë e mungesës së lejes së aktivitetit që lëshohet nga Bashkia Shkodër;
 3. Kopje e shkresës që OSHEE sh.a., Dega Rajonale Shkodër ka dërguar në adresë të tij;
 4. Informacion lidhur me kontratën ekzistuese të shërbimit, mbi bazën e së cilës z. A.K. paguan energjinë elektrike, sipas matësit të vendosur në rulotën që ai ka në shfrytëzim;
 5. Dokumentacioni që duhet plotësuar nga ana e ankuesit A.K., për të lidhur kontratë të re shërbimi me OSHEE sh.a. Dega Rajonale Shkodër;
- Në përgjigje të shkresës nr. 307/1, datë 19.02.2021, së KMD-së, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 3058/1, datë 26.02.2021, nëpërmjet së cilës informon se ky institucion nuk po e diskriminon z. A.K., për shkak të aftësisë së kufizuar, por përkundrazi me anë të politikave dhe projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe jo vetëm, është gjendur pranë shtresave në nevojë.

Sipas shkresës së Bashkisë Shkodër, z. A.K. ka bërë kërkesë për shfrytëzim hapësire publike si shitës ambulant në emër të bashkëshortes së tij, Shpresa A.K., në datën 26.11.2020, në të cilën kërkon vendosjen e një kioske në plazhin e Velipojës. Duke marrë në konsideratë mbingarkesën e informalitetit në këtë zonë turistike, kërkesa nuk është trajtuar për momentin, pasi nuk ka të dhëna të qarta të vendndodhjes së saktë të kioskës, duke krijuar paqartësi nëse cënon apo jo qarkullimin e qytetarëve. Nga fotoja e paraqitur në cilësi provë, Bashkia Shkodër sqaron se kioska është vendosur në hapësirë të gjelbër (lulishte). Hapësirat publike për shitësit ambulantë kanë vende të paracaktuara dhe të formalizuara, në mënyrë të tillë që të mos krijojnë pengesa të mbarëvajtjes së aktiviteteve të ndryshme apo dhe të lëvizjes së këmbësorëve. Në vitin 2017, z. A.K. i është miratuar kërkesa për shfrytëzim të hapësirës publike në Pulaj/Plazh të Njësisë Administrative Velipojë, në një vend të paracaktuar nga Bashkia Shkodër për vendosje tezgash standarde me module të formalizuara. Por, për të qenë përdorues i ligjësuar i hapësirës publike, përveç miratimit të saj nga ana e bashkisë, duhet që kërkuesi të pajiset me NIPT si shitës ambulant, që të faturohet për detyrimet që lindin si subjekt i taksueshëm. Bashkia Shkodër sqaron se Drejtoria Rajonale e Tatimeve është institucioni që ka të drejtën e dhënies së Nipt-it për shitësit ambulantë. Shtetasi A.K. nuk është paraqitur për t'u pajisur me Nipt. Në sistemin e taksave të Bashkisë Shkodër nuk rezulton të

ketë Nipt në emër të tij. Ndaj tij është vendosur gjobë në vitin 2016, për vendosje kioske pa leje të miratuar nga Bashkia Shkodër, gjobë, të cilën ankuesi e ka paguar.

- Në përgjigje të shkresës nr. 307/1, datë 19.02.2021, së KMD-së, Drejtoria Rajonale Shkodër e OSHEE sh.a. dërgoi shkresën nr. 191/1, datë 05.03.2021, nëpërmjet së cilës fillimisht informon se si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore –organizative që kanë ndodhur në shoqërinë Opearatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., kontrata e nergjisë elektrike dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me të janë transferuar tek shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. pjesë e Grupit OSHEE. Në vijim, çdo korrespondencë në lidhje me efektet e kontratës së energjisë elektrike do të trajtohet nga Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Nga OSSH Rajoni Shkodër nuk disponohet informacion nëse shtetasi A.K. ka depozituar kërkesë për kontratë të furnizimit me energji elektrike. Gjithashtu referuar sistemit Mpower nuk rezulton që abonenti me gjeneralitetet A.K. të ketë bërë aplikim për një lidhje të re.

Referuar të dhënave të sistemit të faturimeve, me gjeneralitetet e sipërcituara identifikohen 3 (tre) abonentë me kontrata furnizimi, përkatësisht me nr. SH2A020032141987, nr. SH2A020014029232 dhe me Nr. SH2A020062142257, në instancën Shkodër.

Sipas së njëjtit sistem që përfaqëson bazën e të dhënave të shoqërisë, rezulton se konsumatorët janë regjistruar vetëm me emër e mbiemër dhe jo me atësi. Në bazë të kushteve rregullatore të mëparshme, konsumatorët nuk ishin të detyruar të paraqisnin të dhëna të detajuara personale apo një kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit. Me ndryshimet e fundit të kushteve rregullatore, të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë, konsumatorëve të rinj u kërkohet që të deklarojnë të dhëna personale më të detajuara dhe paraqitjen e dokumentave identifikuese. OSHEE sh.a. e informon gjithashtu KMD-në, mbi dokumentacionin që duhet të plotësojë një aplikant i ri për të lidhur kontratë shërbimi me të.

- Në vijim të shkresave të sipërcituara, Z. A.K. dërgoi me e-mail kundërshtimet e tij në lidhje me shkresën e sipërcituar të Bashkisë Shkodër. Ai shprehet se duhet të ishte njoftuar mbi mangësitë e kërkesës së tij, nga ana e këtij institucioni dhe se Bashkia Shkodër nuk duhet të justifikohet për mostrajtimin e kësaj kërkesë, me faktin se është jo e plotë.

Lidhur me çështjen e pajisjes me NIPT, ai thekson faktin se këtu ekziston një problem, i cili konsiston në faktin se kioska, që ai përdor, ka NIPT në emër të një tjetër personi, përkatësisht z. T.P. Kjo, pasi ai dhe bashkëshortja e tij kanë qenë trajtuar me KMCAP në kohën e aplikimit dhe sipas informacioneve që kishin marrë në atë kohë, ata nuk plotësonin kushtet e hapjes së NIPT-it në emër të tyre. Bashkia Shkodër u ka dhënë leje herë pas here për të përdorur kioskën e tyre, përveçse 2 vitet e fundit, kur ky institucion nuk ua ka dhënë lejen edhe pse çifti i bashkëshortëve ka aplikuar për të. Pavarësisht se NIPT-i i kioskës ka qenë në emër të tjetërkujt, taksat dhe tatimet janë paguar

nga çifti A.K., ndërkohë që z. T.P. qendron herë pas here si shitës në kioskë, kur bashkëshortët nuk ndodheshin aty.

Ankuesi sqaron se gjatë dy viteve të fundit, që ata nuk kanë patur leje për të shfrytëzuar kioskën edhe pse kanë aplikuar pranë Bashkisë Shkodër, Policia Bashkiake është paraqitur herë pas here për kontroll dhe për t'i gjobitur, deri në momentin, që ata i kanë paraqitur NIPT-in e z. T.P. Në kushtet kur, çifti A.K. ka punuar pa patur leje nga Bashkia Shkodër, por ka shfrytëzuar NIPT-in e z. T.P., Bashkia Shkodër ka kërkuar nga ana e tyre që ata të paguajnë të gjithë taksat, të cilat janë paguar me korrektësi. Në këtë kontekst, ankuesi shprehet se nuk e kupton se ku qendron problemi i mosdhënies së lejes, për sa kohë ata i paguajnë rregullisht taksat e vendosura nga ana e Bashkisë Shkodër.

1. Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 307/3, datë 19.04.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohej në datën 27.05.2021, pranë Zyrës së KMD-së.
- Në vijim, në datën 18.05.2021, z. A.K. e njoftoi me e-mail KMD-në se çështja me OSHEE sh.a. ka marrë zgjidhje falë ndërhyrjes së Komisionerit. Ndërkohë që, ai sqaron gjithashtu se bashkëshortja e tij ka aplikuar sërish pranë Bashkisë Shkodër, për shitës ambulat për sezonin veror në Velipojë dhe ky institucion nuk i ka aprovuar ende lejet.

Z. A.K. e informon KMD-në se: “Ne jemi në atë fazë të procedurës pranë KMD, ku me datë 27 maj 2021 është caktuar seanca dëgjimore dhe unë nuk e shikoj të arsyeshme të marr pjesë për faktin sepse problematika me OSHEE është zgjidhur dhe ka mbetur pezull aprovimi i lejes nga Bashkia Shkodër (leje e cila nuk e dimë nëse do të aprovohet ose jo) prandaj unë jam në pritje të përgjigjes nga Bashkia Shkodër dhe vazhdimi i procedurës pranë KMD varet nga qendrimi i saj lidhur me aprovimin ose jo të lejes.”

Z. A.K. dhe Bashkia Shkodër nuk u paraqitën për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të datës 27.05.2021. OSHEE sh.a. Shkodër u përfaqësua në seancë nga z. A. A., përfaqësues i Fumizues i Shërbimit Universal sh.a., i cili u bë me dije nga ana e përfaqësuesve të Komisionerit se pretendimi për diskriminim i z. A.K. ndaj OSHEE sh.a. Shkodër është tërhequr, pasi është arritur qëllimi, për të cilin ka depozituar këtë ankesë.

- Në vijim, në datën 03.06.2021, ankuesi iu drejtua KMD-së me e-mail³, nëpërmjet së cilit njofton se problematika me Bashkinë Shkodër është zgjidhur dhe për këtë arsye kërkon tërheqjen e ankesës së tij ndaj këtij institucioni, pasi qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ, është arritur falë ndërhyrjes së KMD-së.

³ E-maili është dërguar nga ana e specialistes së Zyrës Rajonale Shkodër (KMD), e cila ka përcjellë informacionin përkatës nga ana e z. A. K.

Në këto kushte, Komisioneri gjykoi se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”⁴, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 11, datë 15.02.2021, së z. A.K., për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe shërbime
Shkak – afëtsi e kufizuar
Lloji i vendimit – Arritje efektiviteti

⁴ Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”